



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Lënda : Kthim përgjigje mbi gjendjen e mjeteve,paisjeve dhe numrit të punonjësve zjarrfikës.

I nderuar.

Sa I përket pyetjes tuaj , sa stacione zjarrfikëse ka bashkia Shkoder

-Bashkia Shkodër së bashku me Nj.Adm.në varësi të sajë, ka vetëm një stacion zjarrfikës.

Pyetja e dytë por që lidhet bshkë me pyetjen e katërt është sa mjete zjarrfikëse keni dhe çfar vit prodhimi janë

Për numrin e mjeteve po jua nis bashkangjitur me shkresën, ku janë të specifikuara të gjitha të dhënat dhe kapacitetet e mjeteve dhe paisjeve që kemi.

Pyetja e tretë lidhet me numrin e punonjësve të shërbimit zjarrfikës.

-Drejtoria e shërbimit zjarrfikës Shkodër ka gjithësej 42 punonjës të ndarë në 3 sektore.

Nga këta 42 punonjës, 5 jane me grada të rolit të mesëm, duke përfshirë drejtorin,shëfin e parandalimit,shëfin e ndërhyrjes operacionale dhe 2 inspektor parandalimi.

Tridhjet e katër(34) janë punonjës në rolin bazë. Tre punonjës janë me status civil.

Orgaganizimi I punës në drejtorinë tonë bëhet sipas ligjit 152/21.12.2015, dhe VKM 520/25.07.2019. dhe vijon si më poshtë.

Titullari I Institucionit (Drejtori)

Spektori I Parandalimit, që përbëhet nga 3 veta. shefi I parandalimit dhe 2 Inspektor parandalimi.

Spektori I Nderhyrjes Operacionale, që përbëhet nga shefi I Sek.Oper. dhe 34 efektiv të rolit bazë

Spektori I Mbrapavijës, që nuk janë me status ushtaraku por civil, që përbëhet nga shefi I financës, specialist finance dhe protokoll-arshiv-magazinjer, gjithësej 3 punonjës.

Automjetet, mjetet dhe pajisjet zjarrfikëse gjendje të stacionit zjarrfikëse

Bashkia Shkodër

Mjetet, pajisjet	Sasia, tipi, viti i prodhimit, kapaciteti	Gj. pune	Nevojat	Vërejtje
Automjet Pick Up 4x4 (500-1000 l)			Kemi nevojë për një mjet të tillë	
	Jo	-		
Automjete zjarrfikëse	1-Benz, Vp.1986, Kap.2400 litra	po	Kemi nevojë për një mjet për nisje të parë pasi mjeti që kemi po e mbajmë në gjendje pune me vështirësi pasi ka shumë vite, është prodhim i vitit 1986-të	
	1-Volvo, Vp.1999, Kap.2000 litra	po		
	1-Fiat-Iveko, Vp.2002, Kap.4000 litra	po		
	1-Denisa, Vp.1996, Kap.2800 litra	po		
Automjet 4x4 për pyje	1-Fiat 4x4, Vp.1995, Kap.2400 litra	po		
Autoshkallë zjarrfikëse	1-Autoshkallë- Man, Vp.1985	po		
Autobot zjarrfikës	1-Iveko, Vp.1993, Kap.10000 litra	po		
	1-Iveka, Vp.1993, Kap.8000 litra	po		
	1-Fiat-Iveko, Vp.2002, Kap.8000 litra	po		

Automjet shpëtimi me pajisje	jo		Kemi nevojë për pajisje, pasi mjetin mund ta shpëtojme një nga këto që kemi	
Automjet transporti	1-Fugon benz, Vp.1988	po		
Pompa thithëse uji	3- Pompa thithëse me kap.tub fi 100	po		
Pompa shpine	20-Pompa shpine	po		
Kompresor ajri	1-Kompresor ajri për mbushjen e bombulave	po		
Aparat AP-3	12- Aparat frymërrje(AP-3)	po		
Gjenerator	3-Gjenerator 2fazor&3fazor	po		
Kulla ndriçimi	jo	-	Na nevojitet një copë	
Sistem radioje dore	po	po		
Veshje zjarrduruese	20-Palë	po	Kemi nevojë për 10 palë	
Varka	2-Copë	po		
Treiler për varka	1-Copë	po		
Pajisje CBRN	jo	-	Mirë do ishte të kishim ca pale sipas mundësive.	

Kurse për pyetjen e 5 dhe të fundit që:

A ka bashkia një plan afat shkurtër për blerje mjetesh të reja apo investime të tjera për shërbimin zjarrfikës.

Nga takimet që kemi patur me drejtues të bashkisë Shkodër dhe kryesisht me Kryetarin e bashkisë Z.Benet Beci, kemi gjetur bashkëpunimin dhe mbështetjen për të bërë maksimumin për këtë shërbim që është shumë i domosdoshëm për sigurimin e jetës dhe pronës të qytetarëve të bashkisë Shkodër dhe Njësivë Administrative që janë në varësi të bashkisë Shkodër.

Sa i përket investimeve në ambjentet tona, bashkia Shkodë para një muaji ka nisur investimin për rindërtimin e godinës së vjetër e cila kishte 25 vite që nuk ishte në funksion të asgjëje përveç se një karrikatinë që prishte imazhin e komplet stacionit.kjo do kthehet së shpejti në garazhde për automjetet zjarrfikëse të cilat sot i kemi jashtë gjatë gjithë vitit duke u përballur me kushtet atmosferike.

Duke ju uruar për bashkëpunimin!